



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 91
Prishtinë, më 01.10.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Dhurata Kryeziu-OSBE, Avni Arifi-CDF, Skender Perteshi-QKSS, Lejla Selimi-OSBE.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.09.2013;**
3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.09.2013.

Fatmir Xhelili- Bëri vërejtje që në faqen pesë të procesverbalit të datës 22.09.2013, në pjesën ku fillon fjalia pajtohem të shtohet edhe fjala *pjesërisht*.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22.11.2013 me vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Kryetari i Komisionit- Si Komision edhe më herët kemi pasur vërejtje sa i përketë pozitës së zjarrfikësve. Konsideroj se duhet të formojmë grupin punues i cili do të përgatiste materialin dhe tutje të bëhet amandamenti i këtij projektligji.

Fillimisht do të votojmë në parim këtë projektligj dhe më pas të propozojmë grupin punues për këtë projektligj.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimi në lexim të parë i Projektligjit Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Gjithashtu në këtë pikë të rendit të ditës,

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, me këtë përbërje: Fatmir Xhelili-Kryesues, Rexhep Selimi, Anton Quni, Goran Marinković dhe Danush Ademi-anëtar.

4. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit- Nuk ka çështje për të diskutuar në këtë pikë.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi